



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1018/23 Datë: 26/02/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor:

1. *Agrikulturë me Mjedis MSc 120 ECTS (A)*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik dhe ekspertët si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Agrikulturë me Mjedis MSc 120 ECTS (A)</i>	<i>Ismet Babaj</i> <i>Sami Makolli</i>

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit; *Agrikulturë me Mjedis MSc 120 (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Thomas Thomidis dhe Lali Giorgitze është organizuar më 31.03.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht vetëm dy (2), Pjesërisht pesë (5) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Bazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

